



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 178 Akti

Nr. 158 Vendimi

Tiranë, më 14.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykses i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko

Kryesuese

Alma Faskaj

Relatore

Firdes Shuli

Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 12 qershor 2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Vladimir Mara**, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLP).

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Mara, duke krahasuar “Deklaratën e Pasurisë të Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo bankar etj, të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2018 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 20.11.2018, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Mara.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 3.10.2018, të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 7.11.2018 dhe datën 20.11.2018, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilën, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

8. Në datën 20.5.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

9. Në datën 27.5.2019, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda datës 6.6.2019, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 – 40 dhe 45 – 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

10. Në datën 11.6.2019, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

11. Në datën 10.6.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 12.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në datën 12.6.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jabobs.

14. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, shprehu qëndrimin e tij, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

15. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, kërkoi konfirmimin në detyrë.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 12.6.2019 për të rifilluar në datën 14.6.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Z. Vladimir Mara ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur dhe dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit

48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT / HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

18.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

18.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

18.5 Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komisioni; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

20. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

20.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “Vetting”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Mara.

21. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

22. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2003, 2004, si dhe për periudhën 2008 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

23. Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” (duke përfshirë personat e lidhur), **në datën 27.1.2017**, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Në “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

24. Shtëpi banimi, me adresë: Rr. “ T. V. K.”, Njësia Bashkiake Nr. *, në afërsi të S., Tiranë.**

- Kjo shtëpi është në pronësi të babait të subjektit, z. R. M. (pas përfundimit të procesit të legalizimit).

- Subjekti deklaron se në këtë shtëpi banon ai me familjen (në dy dhoma dhe një kuzhinë që nga viti 2004 e në vijim), dy prindërit, si dhe vëllezërit e tij, së bashku me familjarët e tyre.

Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara¹

24.1 Në deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar faktin se banon në një banesë në zonën e spitalit “S.” në periferi të Tiranës. Në këtë deklaram për këtë banesë subjekti nuk evidenton të drejtë reale.

24.2 Në deklarin periodik të vitit 2008 (para fillimit të detyrës si prokuror), subjekti deklaron: *“Banesë private në bashkëpronësi me 3 (tre) vëllezërit dhe prindërit në proces legalizimi. Ndërtuar në vitin 2000. Kursimet e përbashkëta”*.

¹ Referojuni dokumentacionit të administruar në dosjen e procesit të rivlerësimit. Referojuni dokumentacionit të administruar në dosjen e procesit të rivlerësimit.

Për këtë aset subjekti deklaron se gëzon një pjesë të papërcaktuar në raportin 25 %, vlera e papërcaktuar.

24.3 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur deklaratës “Vetting”, ndër të tjera, edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.1.2017, në të cilën shtetasi R. M. (babai i subjektit) deklaron se është pronar i një trualli me sip. 400 m², ndodhur në Rr. “T. V. K.”, Tiranë, regjistruar me nr. pasurie ***, në të cilën ndodhet një godinë banimi me katër kate (tre kate banim + një garazh), me sipërfaqe 169.3 m². Godina është ndërtuar në periudhën 1999 – 2002, me kontributin e të gjithë anëtarëve të familjes. Babai i subjektit deklaron se ka shitur çdo lloj pasurie që dispononte në rrethin e Matit, si dhe me kontributin e dy djemve të tij, I. dhe A. M., të cilët kanë punuar në emigracion. Në këtë ndërtesë banojnë ai me bashkëshorten, si dhe katër djemtë, së bashku me familjet e tyre. Djali i tij, z. Vladimir Mara, ka në përdorim pa shpërblim dy dhoma dhe një kuzhinë që nga viti 2004 e në vazhdim. Lidhur me këtë objekt nuk është bërë pjesëtim i pasurisë.

24.4 Për sa më sipër, duke u nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit gëzon një të drejtë reale, atë të përdorimit duke përdorur një sipërfaqe të këtij ndërtimi si banesë pa shpërblim, se ky ndërtim është legalizuar në vitin 2015 - kohë në të cilën subjekti ka qenë me detyrë prokuror, si dhe të faktit se subjekti ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit se ai ka kontribuar në një masë të caktuar, duke i dhënë kontribut babait, ashtu si dhe fëmijët e tjerë madhorë, Komisioni çmoi se babai i subjektit, z. R. M., dhe, fëmijët e tij I., A. dhe A. së bashku me bashkëshortet të hetohen me statusin personit tjetër të lidhur në kuptim të pikës 4, të nenit 3, dhe nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

24.5 Për këtë pasuri Komisioni hetoi në këto drejtime:

Lidhur me saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratat periodike dhe në deklaratën “Vetting”

24.5.1 Në deklaratën periodike të vitit 2003 subjekti ka deklaruar si adresë banimi “I.-S.” dhe në deklaratën periodike të vitit 2008 adresë: Rr. “T. V. K.”, Tiranë. Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me adresat e banimit të deklaruara në vite. Subjekti në pyetësonin nr. 2 ka saktësuar se bëhet fjalë për banesën e ndërtuar në Rr. “V. K.”, Tiranë (pranë spitalit “S.”), pra, për të njëjtën banesë, atë të deklaruar në deklaratën “Vetting”. Nga hetimi rezultoi se bëhej fjalë për të njëjtën banesë por në mungesë të një adrese të saktë subjekti ka deklaruar spitalin si një pikë e njohur referimi. Nuk rezultoi gjithashtu nga hetimi që subjekti të ketë përdorur apo të ketë në pronësi një banesë tjetër në këtë zonë.

24.5.2 Nisur nga fakti se në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit deklaron “...bashkëpronësi me 3 vëllezërit...”, për një pjesë ideale të papërcaktuar në raportin 25 %, nga Komisioni u hetua lidhur me përputhshmërinë e deklarimeve të tij me deklaratën “Vetting” dhe saktësinë e deklarimeve të dhëna, përkatësisht, në të dy deklaratat. Nga hetimi administrativ rezultoi se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij nuk ka të regjistruar asnjë pasuri të paluajtshme apo transaksion me emrin e tyre. Nga ALUIZNI rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit, z. R. M., ka qenë subjekt i procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje, sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka dorëzuar në Njësinë Bashkiake Nr. 2, Tiranë, formularin e vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 14.8.2006, nëpërmjet të cilit ka deklaruar se ka zënë truall me sipërfaqe 400 m² dhe ndërtuar mbi të në vitin 1999 një objekt me sipërfaqe 223 m², me katër kate. Për këtë objekt ALUIZNI ka miratuar lejen legalizimi nr. ***, datë 17.11.2015, ku evidentohet se sipërfaqja e truallit nën ndërtim është 169.3 m². Në dokumentacionin shoqërues,

taksat për infrastrukturën i janë llogaritur mbi vlerën e ndërtimit, të përcaktuar në shumën 19,141,774.8 lekë, që i përket sipërfaqes totale të objektit prej 675.6 m².

24.5.3 Për deklarinin *“e bashkëpronësisë me tre vëllezërit dhe prindërit”*, subjekti i rivlerësimit sqaroi se deklarimi i tij në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 (para fillimit të detyrës), nuk lidhet me ndonjë term bashkëpronësie në kuptimin juridik të fjalës, por në një kuptim të fitimit (hipotetik) të pronësisë së banesës së tij në të ardhmen³.

24.5.4 I pyetur⁴ nga Komisioni subjekti deklaroi: *“Gjithashtu, deklarimi si “bashkëpronarë”, edhe për arsye se të gjithë pjesëtarët e familjes kanë kontribuar sipas mundësive dhe me kalimin e kohës secili nga ne fëmijët do të merrte sipërfaqen sipas kontributit të dhënë apo që do të angazhohej të merrte përsipër detyrimet ndaj njëri-tjetrit mbi bazën e sipërfaqes që do të përfitonte, gjithmonë kjo me dëshirën e vullnetin e prindërve, të cilët janë pronarë të shtëpisë. Deklarimi nga unë, që më takon një pjesë e papërcaktuar, është pikërisht për këtë arsye, të faktit që babai akoma s’ka bërë një ndarje të kësaj pasurie...”*. I pyetur për sipërfaqen e ndërtesës që ka në posedim, subjekti i rivlerësimit deklaroi se që nga viti 2004 e në vazhdim posedon të njëjtën sipërfaqe banimi prej 84,65 m² dhe nuk ka kryer asnjë ndryshim.

24.5.5 Duke marrë në konsideratë faktin se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, ka blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.2.2001, truallin me sip. 400 m² mbi të cilin është bërë ndërtimi, ka bërë vetëdeklarimin mbi ndërtimin e kryer në vitin 2006 pranë ALUIZNI-t, si dhe leja e legalizimit ka dalë në emër po të personit të lidhur, Komisioni çmon se e drejta reale e subjektit mbi një pjesë të kësaj ndërtese nuk është bashkëpronësia, por e drejta reale e përdorimit. Për pasojë, Komisioni konstaton mospërputhje të deklarinimit të bërë në vitin 2008 dhe të deklaratës “Vetting” lidhur me të drejtën reale të subjektit mbi një pjesë të kësaj prone.

24.6 Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklarinimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. ka mospërputhje të deklarinimit periodik të vitit 2008 dhe të atij “Vetting” lidhur me të drejtën reale të subjektit mbi këtë pasuri;
- ii. subjekti ka deklaruar saktë të drejtën reale mbi këtë banesë në deklaratën “Vetting”.

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga subjekti, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur

24.7 Komisioni vëren se bazuar në dokumentacionin e depozituar nga ALUIZNI, si dhe në fotot e depozituara nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, kjo banesë ka filluar të ndërtohet që në vitin 1999 dhe vazhdon ndërtimi edhe sot, pasi një pjesë e saj ende nuk ka përfunduar. Për sa më sipër rezultoi e provuar se blerja e truallit dhe ndërtimi kanë filluar para se subjekti i rivlerësimit të ketë qenë subjekt deklarimi në ILDKPKI. Subjekti është emëruar si oficer i policisë gjyqësore në vitin 2000 dhe si prokuror në vitin 2008. Për pasojë nga Komisioni është analizuar burimi i ligjshëm vetëm për ndërtimin e shtëpisë dhe jo për vlerën e truallit, e realizuar kjo nga personi tjetër i lidhur – babai i subjektit.

24.8 Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit deklarinimin e vlerës totale të investuar në krijimin e pasurisë (shtëpia), vlera e investuar prej tij dhe pjesa që përdorte ai në këtë shtëpi, si dhe vlera e investuar prej secilit prej anëtarëve të tjerë madhorë të familjes. Në përgjigjet e tij subjekti i

² Referojuni dokumentacionit të administruar në dosjen e procesit të rivlerësimit.

³ Shihni pyetësorin e datës 27.2.2019.

⁴ Po aty.

rivlerësimit ka vënë në dispozicion një akt të ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme, ing. G. K., nga i cili është konkluduar që *vlera apo kostoja e ndërtimit deri në atë periudhë, momentin e deklarimit para fillimit të detyrës në vitin 2008, është vlerësuar në shumën 8,503,335 (tetë milion e pesëqind e tre mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.*

24.8.1 Në analizë të dokumentit të titulluar “akt ekspertimi” të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni iu kërkuan subjektit sqarime mbi metodologjinë e përlogaritjes së vlerës së punimeve të ndërtimit, duke qenë se nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe i personit tjetër të lidhur deklarohen punime në periudha të ndryshme kohore. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit vuri në dispozicion dokumentin “Shtesë raport vlerësimi”, datë 2.4.2019, të ing. G. K., i cili sqaron se për vlerat e pasqyruara në tabelat përmbledhëse të raportit të vlerësimit është mbështetur në manualin teknik dhe analizat e çmimeve të ndërtimit të vitit 2009, bazuar në VKM-në nr. 30, datë 20.1.2010.

24.8.2 Me qëllim evidentimin në mënyrë sa më të drejtë të vlerës së këtij ndërtimi, me qëllimin për të analizuar burimin e ligjshëm të të gjithë personave të tjerë të lidhur, duke marrë në konsideratë:

- *deklarimet në vite të subjektit në deklaratat periodike vjetore;*
- *deklarimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me gjendjen aktuale të ndërtimit;*
- *aktin e ekspertimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;*
- *analizën e akteve ligjore e nënligjore që parashikojnë miratimin e kostove të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave;*
- *manualin teknik dhe analizat e çmimeve të ndërtimit të vitit 2009, bazuar në VKM-në nr. 30, datë 20.1.2010.*

Komisioni çmoi se jemi para faktit të përcaktimit të vlerës së një ndërtimi në mënyrë deklarative vetëm nga eksperti i caktuar nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë arsye vendosi të përcaktojë vlerën e ndërtimit duke u bazuar në Udhëzimin nr. 362, datë 14.7.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K”, duke marrë pikërisht si vit reference vitin kur ka filluar ndërtimi. Ky referim, nuk është bërë me qëllimin për të analizuar burimin e ligjshëm të subjektit dhe personave të tjerë të lidhur, sepse është e provuar me dokumentacionin që disponon ALUIZNI që ky ndërtim ende sot është i papërfunduar.

Për sa më sipër rezulton se të përfunduara plotësisht duket se janë dy kate të kësaj banese, pra, kati i parë dhe i fundit, të cilët nuk janë të përfunduar plotësisht. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se leja e legalizimit i është akorduar babait të subjektit të rivlerësimit në nëntor të vitit 2015 për objektin shtëpi banimi (me katër kate), dhe ka konsideruar një sipërfaqe të parcelës ndërtimore prej 169.3 m² (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë tre metër katrorë). Kostoja e ndërtimit për qytetin e Tiranës për vitin 2000 është **24,780 lekë/m²**. Sipërfaqja e llogaritur (për tre kate të përfunduara 169.3⁵ m²/kat x 3 kate = 507.9 m²) dhe vlera e ndërtimit e konsideruar në analizën financiare është 507.9 m². **Kostoja totale = 24,780 lekë/m² x 507.9 m² = 12,585,762 lekë.** Kostoja totale e ndërtesës sipas ekspertit vlerësues është në vlerën 10,536,746 lekë ndërkohë që sipas vlerësimit të bërë nga Komisioni, i cili është analizuar më lart, duke iu referuar koston së ndërtimit për vitin 2000, rezulton të jetë **12,585,762 lekë.**

⁵ Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e ALUIZNI-t Komisioni çmon se vlera duhet të llogaritet për tre kate të përfunduara.

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur

24.8.3 Për të analizuar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj shtëpie, i jemi referuar të ardhurave të ligjshme të subjektit, të personave të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur me të për periudhën nga momenti i ndërtimit të shtëpisë e deri në vitin 2015, kur subjekti ka deklaruar se ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë.

24.8.4 Në total, vlera e shtëpisë mbi të cilën janë analizuar burimet e ligjshme të të ardhurave prej secilit prej personave të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur është **12,585,762 lekë**.

Mbi kontributin e subjektit të rivlerësimit

24.8.5 Subjekti deklaron se për periudhën 2000 – 2015, ka pas dhënë afro 1,050,000 lekë nga kursimet e pagës së tij, si kontribut në ekonominë e familjes, duke ja dorëzuar babait të tij (pa përcaktuar nëse këto shuma përdorshin në dobi të ndërtimit ose jo). Deri në vitin 2004 subjekti i rivlerësimit deklaron se i kishte dhënë babait shumën ofro 500,000 lekë ndërsa deklaron se kontributi i tij aktual, arrin në shumën 1,050,000 lekë nga kursimet nga paga e tij dhe nga një kredi konsumatorë në “Raiffeisen Bank”.

24.8.6 Nga deklaratimet e subjektit rezulton se kontributi i tij në ndërtimin e shtëpisë deri në vitin 2003 është = 125,000 x 4 = 500,000 lekë, vlerë e cila është përfshirë në analizën financiare të kryer për këtë periudhë.

24.8.7 Analiza financiare për periudhën 2000 – 2003 rezulton si më poshtë:

| Përshkrimi | 2000 - 2003 |
|---|--------------------|
| Të ardhurat | 1,542,971 |
| Të ardhurat nga paga, subjekti | 1,542,971 |
| Shpenzime | 309,864 |
| Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 309,864 |
| Pasuri | 500,000 |
| Banesë private në bashkëpronësi me tre vëllezërit dhe prindërit në proces legalizimi 25 %, pjesa takuese e subjektit 84.65 m ² | 500,000 |
| Të ardhura – shpenzime - pasuri | 733,107 |

24.8.8 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, u krye analiza financiare për periudhën 2000 – 2003. Nga analiza e të dhënave lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, konstatohet se për periudhën 2000-2003 rezulton se subjekti ka patur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe.

24.8.9 Në deklaratën periodike të vitit 2004 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash*. Nisur nga deklaratimet e subjektit rezulton se kontributi i tij në ndërtimin e shtëpisë në vitin 2004 është në vlerën 100,000 lekë, vlerë e cila është përfshirë në analizën financiare të kryer për këtë periudhë në vijim. Me qëllim realizmin e një analize të saktë financiare për të gjitha vitet që ka qenë subjekt deklarimi, subjekti është pyetur me pyetësorin e datës 27.2.2019 edhe për shpenzimet e arredimit të deklaruara prej tij në pyetësorin standard, dhe i është kërkuar vlera e arredimit për secilën periudhë kur është kryer. Subjekti ka deklaruar: “Në gjendjen aktuale, vlera e arredimit

është përafërsisht 600,000 lekë, pasi mobilet e blera në vitin 2004 dhe 2005 janë zëvendësuar dhe një pjesë e mobilieve në vitin 2007 janë amortizuar pjesërisht.”

24.8.10 Analiza financiare për vitin 2004 rezulton si më poshtë:

| Përshkrimi | 2004 |
|---|----------------|
| Të ardhurat | 580,886 |
| Të ardhurat nga paga, subjekti | 580,886 |
| Shpenzime | 143,864 |
| Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 93,864 |
| Shpenzime arredimi | 50,000 |
| Pasuri | 100,000 |
| Banesë private në bashkëpronësi me tre vëllezërit dhe prindërit në proces legalizimi 25 %, pjesa takuese e subjektit 84.65 m ² | 100,000 |
| Të ardhura - shpenzime - pasuri | 337,022 |

24.8.11 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, u krye analiza e tregueseve financiarë për vitet 2004. Nga analiza e të dhënave lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, konstatohet se për vitin 2004 subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë këtij viti.

24.8.12 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të depozituar në ILDKPKI në datën 4.12.2008 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përbërjen familjare bashkëshorten dhe vajzën e tij. Subjekti është pyetur lidhur me automjetin tip “Volkswagen” me targë TR ***, të blerë në vitin 2007, në shumën 4,000 euro, për të cilin ka deklaruar se: “... e kam blerë me të ardhurat nga kursimet dhe pjesërisht nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”. Subjekti ka specifikuar se sa ka qenë vlera e kursimeve të përdorura për blerjen e kësaj makine dhe sa është shuma e përdorur nga kredia e marrë për blerjen e këtij automjeti. Gjithashtu ai është pyetur lidhur me qëllimin e përdorimit të kredisë dhe për çfarë është përdorur pjesa tjetër e kredisë. Subjekti, ndër të tjera, deklaroi:

“Me kredinë e marrë në vitin 2007, kam financuar pjesërisht për arredim. Nga sa sqarova më lart lidhur me arredimet, shuma e përdorur nga kredia për arredim ka qenë 150,000 lekë, të cilat janë përdorur për blerjen e pajisjeve të ndryshme shtëpiake dhe mobilje.

Një pjesë tjetër nga kredia në shumën 150,000 lekë i është dhënë babait tim për nevoja të tij për shpenzime të ndryshme shtëpiake.

*Nga kursimet nga paga të mbartura nga viti i mëparshëm në shumën 100,000 lekë, si dhe 380,000 lekë të përdorura nga kredia e marrë, kam blerë automjetin tip “Volkswagen” me targë TR ***. Pjesa tjetër e kredisë është përdorur për shpenzime të ndryshme shtëpiake dhe familjare, komisione bankare, interesa.”*

24.8.13 Analiza financiare për periudhën 2005 – 2007 dhe për vitin 2010 rezulton si më poshtë:

| Përshkrimi | Periudha 2005 – 2007 |
|--|-----------------------------|
| Të ardhurat | 2,151,773 |
| Të ardhura nga paga, subjekti ⁶ | 2,151,773 |
| Detyrime | 1,000,000 |
| Kredi bankare në “Raiffeisen Bank” | 1,000,000 |
| Shpenzime | 1,785,424 |
| Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 1,365,246 |
| Shpenzime arredimi | 210,000 |
| Shpenzime për shlyerje kredie (principal + interes) | 210,178 |
| Pasuri | 833,640 |
| Automjet tip “Volkswagen” me targë TR ***, vlera: 4,000 euro ⁷ | 483,640 |
| Banesë private në bashkëpronësi me tre vëllezërit dhe prindërit në proces legalizimi 25 %, pjesa takuese e subjektit sip. 84.65 m ² | 350,000 |
| Likuiditete në fillim të periudhës⁸ | 0 |
| Likuiditete në fund të periudhës | -40,176 |
| Llogari rrjedhëse në “Raiffesien Bank”, subjekti | -60,085 |
| Llogari rrjedhëse në “Raiffesien Bank”, bashkëshortja e subjektit | 19,909 |
| Të ardhura +detyrime - shpenzime – pasuri + likuiditete në fillim të periudhës - likuiditete në fund të periudhës | 572,885 |

24.8.14 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, u krye analiza e tregueseve financiarë për vitet 2005 – 2007 dhe vitin 2010. Nga analiza e të dhënave lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur, konstatohet se për vitet 2005 –2007 dhe për vitin 2010 rezulton një balancë pozitive e fondeve.

Mbi kontributin e babait të subjekti i rivlerësimit, z. R. M., personit tjetër të lidhur

24.8.15 Komisioni me qëllim analizën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, babait të subjektit, z. R. M., mori në konsideratë dokumentacionin e depozituar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të sjellë në Komision⁹ në datën 25.4.2019. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Babai siguronte të ardhura neto në vit nga rroga e tij si mësues, të ardhura nga prodhimet bujqësore, blegtorale e frutore, si dhe nga shitja në një pikë shitje (dyqan) i ndodhur në tregun e qytetit Burrel (periudha 1991–1996) në një shumë mesatare në vit nga jo më pak se 50,000 lekë në vit. Nga viti 1996 deri ne vitin 2004 babai ka kursyer afërsisht një shumë prej 100,000 lekë në vit.”* Në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, konkretisht të vërtetimeve të sjella nga subjekti për të ardhurat nga punësimi u qartësua nëse këto të ardhura ishin *neto* apo *bruto*. Duke qenë se informacioni ishte sipas borderove Komisioni çmoi se në këtë rast kemi të bëjmë me të ardhura *neto*.

⁶ Shihni në dosjen e ILDKPKI-së vërtetimin nr. prot.N.Z. me datë 12.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

⁷ Konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007.

⁹ Shikoni përgjigjet e pyetësorit të sjella në Komision, në datën 25.4.2019

Në tabelën e mëposhtme paraqitet pasqyra përmbledhëse për të ardhurat e ligjshme të babait të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 – 2004.

| Ramiz Mara | 1992 | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | TOTALI |
|--------------------------------|-------|--------|--------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|
| Bashkia Mat | | | 72,641 | 110,487 | 143,549 | 147,566 | 186,479 | 208,186 | 240,236 | 287,405 | 306,841 | 320,314 | 260,874 | 2,284,578 |
| Bashkia Mat anëtar I Këshillit | 9,000 | 21,600 | 21,600 | 45,600 | 55,200 | | | | 55,200 | 55,200 | 55,200 | 55,200 | 65,040 | 438,840 |
| TOTALI | 9,000 | 21,600 | 94,241 | 156,087 | 198,749 | 147,566 | 186,479 | 208,186 | 295,436 | 342,605 | 362,041 | 375,514 | 325,914 | 2,723,418 |

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit Komisioni çmoi se babai i subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme për të kontribuar pjesërisht në ndërtimin e kësaj shtëpie.

Mbi kontributin e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. I. M.,¹⁰ personit tjetër të lidhur

24.8.16 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se personi tjetër i lidhur, vëllai i tij ka kontribuar me shumën *afro 5,058,590 lekë* me burim nga të ardhurat e siguruar nga puna gjatë emigrimit të tij në Greqi, për periudhën 1996 – 2001, si dhe nga shitja e një prone në qytetin e Burrelit me kontratë shitje nr. ***, datë 18.7.2008, përpara noterit publik, z. G. D., Burrel. Çmimi i shitjes të apartamentit është 650,000 lekë. Subjekti deklaroi se këtë shumë ia ka dorëzuar babait të tij herë pas here, me agjenci të transferimit monetar ose *cash* në dorë, si dhe në shumën 148,605 lekë, nga të ardhurat nga puna si emigrant në Angli nga viti 2001 e në vazhdim. Në pyetësor subjekti deklaroi: “Vëllai im, I. M. ka punuar në emigracion që nga viti 1991, në Greqi. Ai është pajisur me dokumentacion të rregullt qëndrimi në vitin 1998. Deri në vitin 1996 qëndrimi i tij në shtetin Grek, ka qenë provizor duke punuar me sezone. Nga viti 1997 dhe deri në vitin 2008 ai ka punuar dhe jetuar në shtetin Grek. Dërgesat e tij në Shqipëri kryesisht silleshin në ardhjet e tij periodike në Shqipëri, por edhe me transferta me Western Union. Siç është dhënë më sipër në vitin 2002 është siguruar një transfertë e kryer në shumën 1,111 USD e ruajtur nga babai im”.

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dokumentacionin lidhur me të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, vëllait të tij, në formën e kërkuar nga ligji si më poshtë:

- vërtetim nga shtetasja E. Ch. për lënien në përdorimin e tokës për periudhën 2000 – 2005;
- vërtetim i lëshimit të NIPT-it në datën 15.3.1999 për të siguruarin I. M.;
- dokumentet që vërtetojnë qëndrimin e shtetasit I. M. dhe familjarëve të tij në shtetin grek dhe rinovim të lejes së qëndrimit;
- leje pune për shtetasit e huaj;
- vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Njësia Vendore Meligala, që vërteton sigurimin e shtetasit I. M. për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005;
- paraqitja përfundimtare e tatimeve mbi të ardhurat personale fizike mbi bazë deklarimi për shtetasin I. M. për vitet 2004 dhe 2005;
- librezë e llogarisë bankare në emër të shtetasit I. M. dhe bashkëshortes së tij në Bankën Kombëtare Greke nga viti 2003 deri në vitin 2006;
- dokument zyrtar për pagesat e taksave në shtetin grek për vitet 2004 dhe 2005 në formën e kërkuar nga ligji, vite për të cilat janë marrë në konsideratë dërgesat në emër të babait; si dhe

¹⁰ Shikoni dokumentacion e bashkangjitur në përgjigjet e pyetësorit të sjella në Komision, në datën 11.3.2019.

- kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.7.2008, të apartamentit në qytetin e Burrelit.

Lidhur me të ardhurat nga emigracioni në kushtet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016

1. Është provuar me dokumentacion justifikues se: *personi tjetër i lidhur rezulton me dokumente qëndrimi të rregullta në shtetin grek nga viti 1999 vit në të cilin ai ka është pajisur me NIPT*. Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se: *ai ka paguar detyrime tatimore për vitet 2004 dhe 2005 duke provuar kështu ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave të depozituara në këto dy vite;*
2. *Vëllai i subjektit të rivlerësimit arrin të justifikojë me burime të ligjshme financiare kontributin në ndërtesën e shtëpisë në shumën 1,750,600 lekë ku përfshihen (kontributi i vëllait të subjektit, z. I. M., është vlerësuar në bazë të dërgesave të vitit 2004 (6,000 euro) dhe viti 2005 (4,000 euro), vite të cilat personi tjetër i lidhur ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e gjeneruara gjatë kësaj periudhe dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit (500,000 lekë).*
3. *Lidhur me transferimin e të ardhurave te babai i subjektit ekziston vetëm një transfertë në datën 28.7.2002 në shumën 1.111,15 USD.*
4. *Në vitin 2003 rezulton një tërheqje nga llogaria e tij bankare, e cila është në vlerën që deklaroi subjekti në pyetësor dhe që lidhet me kontributin e tij në vitin 2003.*

24.8.17 Komisioni çmon se nga tërësia e provave rezulton se personi tjetër i lidhur, z. I. M., ka pasur burime të ligjshme për të bërë të mundur financimin e pjesëm të krijuar nga ana e tij në krijimin e pasurisë së analizuar. Nëpërmjet të ardhurave të dërguara nga ana e tij, personit tjetër të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit rezulton e provuar se ky i fundit ka pasur të ardhura të ligjshme për të kontribuar në krijimin e kësaj pasurie.

Mbi kontributin e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A. M., personit tjetër të lidhur

24.8.18 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se personi tjetër i lidhur ka kontribuar me shumën *afro 7.905.596. lekë* me burim nga të ardhurat e siguruar nga puna gjatë emigrimit të tij në Angli. Siç rezultoi dhe nga provat shkresore të administruara personi tjetër i lidhur këtë shumë ia ka dorëzuar babait të tij herë pas here me agjenci të transferimit monetar. Sipas dokumentacionit që provon dërgesat e parave nëpërmjet operatorëve të licencuar, rezulton se personi tjetër i lidhur, z. A. M., ka dërguar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit nga viti 2001 deri në vitin 2015 shumën prej **6,503,389,4** lekë, duke iu referuar vitit 2015, duke qenë se në vitin 2015 babai i subjektit të rivlerësimit ka marrë lejen e legalizimit të kësaj shtëpie, por dërgesat e vëllait të subjektit të rivlerësimit sipas dokumentacionit vazhdojnë deri në vitin 2018. Në përgjigje të pyetësorit të dërguar në Komision subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion ligjor provues lidhur me taksat e paguara dhe lëvizjet e llogarisë bankare të vëllait të tij, z. A. M., lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi për periudhën 2003 – 2018. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për të provuar të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, vëllait të tij, z. A. M., si vijon:

- lista e pasqyrave bankare origjinale të vëllait, z. A. M. nga janari i vitit 2005 deri në mars të vitit 2019 nga banka Halifax;
- detaje të të ardhurave nga “HM R. & C.” për periudhën 2004 – 2018 të nënshkruara dhe të legalizuara nga kontabilisti i certifikuar me licencë dhe auditues i regjistruar R., për tatimet personale të klientit A. M., të noterizuara nga I. N. Ll., avokat nga zyra e Avokatisë, C. J.–

“OPUS Brickëork Limited Annual Report and Unaudited financial statements for the year ended 30 April 2018” A. M. (director).

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se: për periudhën 2003 – 2019, z. A. M., ka pasur të hyra në vlerën **865.213 GBP**. Ai rezulton me dokumente qëndrimi të rregullta në shtetin Anglez nga viti 2001, ku ka paguar detyrime tatimore për periudhën 2003 – 2018, duke provuar kështu ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave të dërguara në këto vite.

24.8.19 Komisioni çmon se nga tërësia e provave rezulton se personi tjetër i lidhur, z. A. M., ka pasur burime të ligjshme për të bërë të mundur financimin e pjesshëm nga ana e tij të krijimit të pasurisë së analizuar, nëpërmjet të ardhurave të dërguara nga ana e tij personit tjetër të lidhur - babait të subjektit të rivlerësimit.

Mbi kontributin e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A.M., personit tjetër të lidhur

24.8.20 Subjekti i rivlerësimit deklaron se personi tjetër i lidhur, vëllai i tij, ka kontribuar me shumën totale prej 500.000 lekësh, të cilat i ka dhënë babait të tij. Subjekti shpjegon se: “Vëllai A. M., sipas tij dhe babait, R. M., ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë shumën totale 500,000 lekë. Nga këto, shuma 100,000 lekë janë dhënë babait në vitin 2001 dhe 400,000 lekë të tjera janë financuar në shtëpi në vitin 2008. Burimi i të ardhurave për shumën 100,000 lekë kanë qenë të ardhurat nga paga e tij si punonjës bashkë si dhe bashkëshortes së tij si mësuese. Shuma 400,000 lekë është financuar nga kredia e marrë në vitin 2008”.¹¹

Në vijim analiza financiare e personit tjetër të lidhur për periudhën 1999 – 2001

| Të ardhurat | 16 shtator 1999 – 2001 |
|---|-------------------------------|
| A. M. | 166,718 |
| T. M. | 351,844 |
| Total të ardhura | 518,562 |
| Shpenzime jetese | 412,500 |
| Total shpenzime | 412,500 |
| Diferenca të ardhura - shpenzime | 106,062 |

24.8.21 Komisioni çmon se nga tërësia e provave rezulton se personi tjetër i lidhur, z. A. M., ka pasur burime të ligjshme për të bërë të mundur financimin e pjesshëm nga ana e tij në krijimin e pasurisë së analizuar nëpërmjet të ardhurave të dërguara nga ana e tij personit tjetër të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit.

24.8.22 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë për gjendjen e kësaj pasurie në momentin e deklarimit;
- ii. rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe të drejtën reale të përdorimit mbi të;

¹¹ Referojuni përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, protokolluar në datën 11.0-3.2019, nga Komisioni.

- iii. subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

25. Kursime nga paga si Oficer i Policisë Gjyqësore, që nga data 1.2.2000, si prokuror që nga data 29.7.2008 e në vijim dhe nga paga e bashkëshortes si mësuese nga viti 2006 e në vijim:

- i. vlera e deklaruar në shumën 950,000 lekë;
- ii. çelje llogarie kursimesh në muajin gusht të vitit 2012 në emër të vajzës time E. M., në “Raiffeisen Bank”;
- iii. vlera e deklaruar në shumën 200,000 lekë (interes 31,703 lekë);
- iv. pjesa takuese: 100 %.

Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara

25.1 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarambi të ardhurat dhe pasurinë e tij në vitet 2003 (për herë të parë) dhe 2004, dhe më pas për vitin 2008 e në vazhdim. Për periudhën 2005 – 2007 subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarambi në ILDKPKI për shkak të ndryshimeve në ligj.

25.2 Të ardhurat e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit si në deklaratat periodike dhe në deklaratën “Vetting” janë: paga nga puna fillimisht si OPGJ dhe më pas si prokuror, si dhe paga nga puna si pedagog në Universitetin e Durrësit, si dhe paga e bashkëshortes nga puna si mësuese¹². Personi i lidhur bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është aktualisht mësuese në shkollën “1 Maj” në qytetin e Tiranës.

25.3 Në deklarimin e pasurive dhe interesave të viteve 2003, 2004, 2008 – 2010, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi gjendje kursimesh. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, për herë të parë deklaroi gjendje kursimi në shumën 200,000 lekë, me burim: nga paga e tij dhe e personit të lidhur, bashkëshortja, por nga deklarimi nuk evidentohet nëse i ka gjendje në bankë apo *cash* në shtëpi. Nga hetimi dhe komunikimi zyrtar me institucionet financiare rezultoi se kjo shumë rezultoi në gjendje *cash*.

25.4 Sipas analizës financiare të krijimit të gjendjes së kursimeve të deklaruara rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme të ardhurave për të krijuar kursimet e deklaruar si në deklaratat periodike edhe në deklaratën “Vetting”.

25.5 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklarambi e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me likuiditetet e deklaruara Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. përputhet deklarimi i subjektit me gjendjen e likuiditeteve sipas dokumentacionit të institucioneve bankare;
- ii. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme të ardhurave për të krijuar kursimet e deklaruar si në deklaratat periodike edhe në deklaratën “Vetting”.

26. Automjet me targë *, aktualisht jashtë përdorimit, sipas deklarimit të subjektit**

Burimi i krijimit: të ardhurat nga shitja e një automjeti tip “Volkswagen” me targë TR ***, të blerë në shumën 4,000 euro, me kontratën e datës 30.5.2007 dhe të shitur me kontratën e datës 10.7.2009, kundrejt shumës 400.000 lekë.

¹² Referojuni fashikullit të akteve të administruara nga kontrolli i ushtruar nga ILDKPKI-ja, në kuadër të procedurave të rivlerësimit kalimtar, ku janë administruar vërtetimet e institucioneve punëdhënëse mbi pagat e subjektit dhe personit të lidhur

Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ dhe provat e administruara¹³:

26.1 Lidhur me automjetin tip “Volksäagen” me targë TR *, të blerë në shumën 4.000 euro, me kontratën e datës 30.5.2007**

26.1.1 Në deklarinimin “*përpara fillimit të detyrës*”, viti 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “3. *Automjet “Volkswagen” me targë TR ***; me kredi; vlera: 420.000 lekë*”.

26.1.2 Rezulton se ky aset është blerë me kontratën e shitblerjes së datës 30.5.2007, kundrejt shumës 4.000 euro, shlyer jashtë zyrës noteriale. Këtë automjet, subjekti i rivlerësimit e shet në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 10.7.2009, në shumën 400,000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale.

26.1.3 Nga analiza financiare e vitit 2007, e parashtruar më lart rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

26.1.4 Komisioni, në analizë të provave të administruara, çmon se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të saktë për këtë pasuri dhe ka deklaruar saktë burimin e krijimit të saj;
- ii. në analizën financiare të vitit 2007 subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

26.2 Lidhur me automjetin me targë * blerë në shumën 3,000 euro në vitin 2009**

26.2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar fillimisht në deklarinimin periodik të vitit 2008 lidhur me këtë automjet, duke deklaruar: “1. *Shitje automjeti tip “Volksäagen” me targë TR *** me vlerën 400,000 lekë; 2. Blerje automjeti tip “Land Rover Freelander” në shumën 3,000 euro*”.

26.2.2 Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një prokurë të posaçme, nr. 4179/727, datë 2.6.2009, në të cilën pala porositëse D. M., autorizon subjektin, z. Vladimir Mara, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, për sa i përket përdorimit brenda dhe jashtë vendit të automjetit në pronësi të tij, tipi “Land Rover”, vit prodhimi 2000, targë ***, regjistruar në Angli. Subjektit i jepet gjithashtu e drejta e shitjes së automjetit (kujtdo personi apo vetes së tij), zhdoganimit dhe çdo veprimi tjetër që nuk është shprehur në prokurë.

26.2.3 Komisioni hetoi lidhur me datën e hyrjes së automjetit në Shqipëri dhe personin që udhëtonte, marrëdhënien e tij me subjektin e rivlerësimit, datën e vënies në posedim të makinës nga subjekti i rivlerësimit, marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shtetasin D. M., mënyrën e transferimit të pronësisë së automjetit, mënyrën e likuidimit të shumës 3.000 euro ndaj pronarit D. M., si dhe mbi dokumentacionin e pronësisë së automjetit që subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar për dëshmipërblim nga shoqëria INSIG sh.a.

26.2.4 Nga hetimi rezultoi e provuar se automjeti ka hyrë në vend nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Porti Durrës në datën 1.6.2009. Me këtë automjet ka udhëtuar shtetasi D. M., i cili ka qenë drejtues i mjetit kur e ka futur atë në Shqipëri. Z. D. A. M. rezulton të jetë i afërm (djali i xhaxhait të tij), referuar certifikatës së babait të tij, z. R. M. M., të xhaxhait të tij, z. A. M. M. dhe të djalit të xhaxhait të tij, z. D. A. M.. Subjekti këtë automjet e ka marrë me prokurë të posaçme para noterit në datën 2.6.2009 nga pronari i mjetit, D. M. . Automjeti ka qenë i pajisur me të gjithë

¹³ Referojuni dokumentacionit të administruar në dosjen e procesit të rivlerësimit.

dokumentacionin përkatës, me të cilat D. M. kishte udhëtuar më këtë automjet nga Anglia në Shqipëri, duke vënë në dispozicion fotokopje të tyre. Subjekti i rivlerësimit nuk lidhi një kontratë shitje për këtë automjet dhe për pasojë as e regjistroi këtë në drejtorinë përkatëse të shërbimit të transportit rrugor, duke mos paguar në vijim as detyrimet doganore. Kontrata e shitjes nuk ndodhi edhe pas dy vjetësh nga momenti i disponimit të këtij mjeti pasi ky automjet u dëmtua komplet dhe as nuk u rregullua apo përdorur më tej. Pas ngjarjes së aksidentit subjekti i rivlerësimit deklaroi se pranë INSIG sh.a. ka dorëzuar të gjithë dokumentet e mjetit dhe formalitetet e mbajtura nga ana e policisë për këtë aksident. Nga kjo shoqëri është dëmshpërblyer për dëmin e pësuar në datën 29.12.2011, nëpërmjet “Tirana Bank”. Subjekti i rivlerësimit e shoqëron përgjigjen me një fashikull aktesh shkresore të vëna në dispozicion nga INSIG sh.a. Rezulton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë të dhënë apo provë mbi kalimin në pronësinë e tij të automjetit dhe as ndonjë dokument të pagesës së shumës 3,000 euro. Sipas deklarimeve të subjektit këtë shumë ia ka dhënë në dorë shtetasit D. M. në datën 22.7.2009, gjatë kohës që ai kishte ardhur nga Anglia në Shqipëri me pushime. Sipas deklarimit shuma buroi nga çmimi i shitjes së automjetit në datën 10.7.2009, tip “Volkswagen” me targë TR ***, në shumën 400 mijë lekë.

26.2.5 Nga hetimi rezultoi e provuar se për këtë automjet nga subjekti i rivlerësimit nuk është nënshkruar asnjë akt ligjor shitblerje. Pavarësisht deklarimit të subjektit që kishte likuiduar vlerën prej 3000 eurosh ky fakt nuk u mbështet në ndonjë provë. Për këtë arsye Komisioni çmoi se mbi këtë mjet subjekti gëzonte të drejtën e përdorimit. Për sa më sipër Komisioni vlerësoi se z. D. M. gëzon statusin e personit tjetër të lidhur bazuar në pikën 14, të nenin 3 dhe nenin 32, të ligjit nr. 84/2016.

26.2.6 Subjekti paraqiti shpjegime lidhur me faktin se ai nuk e ka përdorur këtë automjet dhe për këtë arsye nuk e ka regjistruar. Nga hetimi rezultoi i bazuar në dokumente shkresore që automjeti ishte përdorur me policën e sigurimit vetëm për një vit, në respektim të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, por pa qenë i regjistruar në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor. Fakti rezultoi i provuar edhe nga dokumentacioni i aksidentit që iu shkaktua subjektit në një moment që drejtonte këtë automjet.

26.2.7 Komisioni çmon se përdorimi i një makine të paregjistruar sipas legjislacionit në fuqi përbën një element të rëndësishëm të etikës për një prokuror. Në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. Në këto kushte Komisioni çmon se kjo çështje duhet të jetë objekt i një procedimi disiplinor nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenin 103, të ligjit nr. 96/2016 datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

26.2.8 Nga analiza financiare e vitit 2009 rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

26.2.9 Në analizë të burimit të ligjshëm të personit tjetër të lidhur D. M., nga Komisioni ju kërkuan subjektit dokumentacion provues lidhur me mundësitë financiare të tij për të blerë këtë aset. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion nga institucionet bankare në Angli, sipas formës së kërkuar nga ligji, të dhëna për të ardhurat e shtetasit D. M. për vitin 2009. Nga dokumentacioni i depozituar për lëvizjet bankare të shtetasit D. M. në “Bankën Nationwide” për periudhën **18 nëntor 2008 – 18 janar 2009** rezultoi se totali i kreditimeve për këtë shtetas për këtë periudhë është në shumën **16,591.95 GBP**.

Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit çmon se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka përdorur një makinë, e cila nuk ka qenë regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, element ky i rëndësishëm i etikës në ushtrimin e detyrës si prokuror, dhe për këtë arsye të dërgojë këtë çështje në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me qëllim që ta shqyrtojë në bazë të nenit 100 e vijues të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- ii. personi tjetër i lidhur D. M. provon me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj makine.

27. Automjeti “Mercedes Benz”, prodhim i vitit 2001

Burimi i krijimit: Shuma e parave të marra nga “Tirana Bank”, si dëmshpërblim nga shoqëria e siguracionit INSIG sh.a, shumë e tërhequr në datën 29.12.2011 dhe nga kursimet familjare. Vlera 600,000: lekë. Pjesa takuese: 100 %.

27.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklarimin e pasurive të vitit 2012 bazuar në kontratën nr. *** rep., datë 17.1.2012, blerje automjeti në vlerën 600,000 lekë. Në këtë deklaram periodik subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

27.2 Duke analizuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, për sa i takon origjinës së burimit të krijimit të këtij aseti të luajtshëm, rezulton se automjetin e ka blerë: pjesërisht me të ardhurat e siguruara nga dëmshpërblimi i dhënë nga shoqëria e siguracionit INSIG sh.a., për automjetin tip “Land Rover” me targa angleze *** dhe pjesërisht me kursime nga të ardhurat e realizuara nga paga e tij.

27.3 Në hetim të analizës financiare për burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni analizoi ligjshmërinë e aktit të përfitimit të dëmshpërblimit të marrë nga shoqëria e siguracionit INSIG dhe analizën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2012.

27.4 Komisioni hetoi të dhënat nga sistemi i shitjeve të policave të siguracionit nga AMF-ja mbi këtë automjet. Nga të dhënat e regjistruara në këtë sistem rezulton se në datën 1.6.2009 është blerë polica e siguracionit nr. *** për këtë automjet nga shoqëria “A.” sh.a., nga pika e shitjes në qytetin e Durrësit. Person i siguruar është shtetasi anglez D. M., i datëlindjes 25.3.1975, i cili, në momentin e ngjarjes së aksidentit në autostradën Durrës – Tiranë (datë 11.7.2011), rezulton i siguruar bashkë me subjektin e rivlerësimit në policën e siguracionit nr. ***, datë 7.10.2010, të shoqërisë INSIG sh.a.. Ky fakt i fundit konfirmohet edhe nga fashikulli i akteve të vëna në dispozicion nga shoqëria INSIG sh.a. gjatë hetimit administrativ. Në datën 11.7.2011 ndodh një aksident në autostradën Durrës – Tiranë, pranë mbikalimit në Kashar, ku si pasojë e ndryshimit të gabuar të korsive nga një automjet tjetër (“Mercedes Benz”), u përfshinë në aksident edhe dy automjete (“Land Rover” dhe “Peugeot”). Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar dëmshpërblim shoqërisë INSIG sh.a. për shkak se automjeti “Land Rover” nuk ishte më në gjendje funksionale dhe kostot për riparimin e tij nuk justifikonin vlerën e mëtejshme të automjetit. Pas vlerësimit të situatës dhe dëmeve të shkaktuara tek automjetet e përfshira në aksident, shoqëria e siguracionit INSIG sh.a. vendosi që të dëmshpërblejë me shumën 477,030 lekë, të cilën ia ka likuiduar nëpërmjet transfertës nga “Tirana Bank” në datën 29.12.2011.

Nga hetimi rezultoi se:

Bazuar në nenet 608 e vijues të Kodit Civil, në ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 3 (*përkufizime*), pikat 9 dhe 10, e neni 11 (*E drejta e*

palës së dëmtuar të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim), pika 9 dhe 10, e nenit 3 ku parashikohet se: 9. “Palë e siguruar” është personi, interesi pasuror i të cilit është i siguruar. 10. “Palë e dëmtuar” është çdo person që ka pësuar dëme, të cilit i lind e drejta të kërkojë dëmshpërblim, sipas këtij ligji, për humbjet apo dëmtimet e pësuar, të shkaktuara nga mjeti i transportit”, Neni 11 “E drejta e palës së dëmtuar të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim”.

1. Pala e dëmtuar, bazuar në sigurimin, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, **ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguroesi, përgjegjës i pronarit të mjetit, me të cilin është shkaktuar aksidenti.**

Kërkesa për dëmshpërblim mund të paraqitet me shkrim ose në rrugë elektronike.

2. Kërkesa për dëmshpërblim, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të përfshijë dëmshpërblimin e dëmeve pasurore dhe jopasurore”.

27.5 Subjekti i rivlerësimit ka përfituar konform legjislacionit në fuqi dëmshpërblimin si pasojë e dëmit që i ka ardhur si pasojë e aksidentit.

27.6 Nga analiza financiare e vitit 2012 rezulton se subjekti ka një bilanc pozitiv në fund të këtij viti..

27.8 Për sa më sipër, pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të subjektit, shpjegimeve që ai ka dhënë, në përfundim të hetimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. deklarimi i subjektit të rivlerësimit për pronësinë e tij mbi automjet tip “Mercedez Benz”, i vitit të prodhimit 2001, me targë ***, të blerë në shumën 600,000 lekë, është i saktë;
- ii. ekziston burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie si ai i shumës 477,030 lekë nga shoqëria e siguracionit INSIG sh.a., si dhe kursimet familjare, të cilat rezultojnë të provuara pas analizës financiare të realizuar.

28. Lidhur me kreditë konsumatore

28.1 Nga informacioni i administruar në dosjen e Komisionit nga bankat e nivelit të dytë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë me këste nëpërmjet “Raiffeisen Bank” me përshkrimin “Blerje Trony” në datën 23.4.2010. Ky detyrim në shumën 77,900 lekë ndaj “Raiffeisen Bank” nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2010.

28.2 Subjekti është pyetur lidhur me kreditë e vogla konsumatore të cilat kanë rezultuar nga hetimi administrativ, por që nuk janë deklaruar nga subjekti apo bashkëshortja e tij, dhe në përgjigje të pyetësorit, ai, ndër të tjera, ka deklaruar: “Lidhur me blerjen e datës 23.4.2010, në shumën 77,900 lekë, është blerë një televizor nga paga ime dhe këtë fakt unë e kam deklaruar në deklarin periodik të vitit 2010. Për sa i përket blerjes së datës 30.7.2015, sqaroj se në të vërtetë nuk janë blerë tablet “Lenovo NPM 90” dhe “Lenovo S90”, por është blerë një dyshek me pagën e bashkëshortes time F. M. . Për sa i përket blerjeve të tjera nga paga e bashkëshortes sime, duke parë që janë në blerje të vogla, të likuiduara brenda vitit po nga paga e saj, është kuptuar ky fakt si shpenzim i bërë nga ana e bashkëshortes sime, nisur nga fakti që sipas formularit të deklarinimit të pasurive të paluajtshme ku parashikohet deklarimi i shpenzimeve të kryera në vlerë mbi 300 000 lekë, nuk është çmuar të deklarohet duke e konsideruar si shpenzim. Mosdeklarimi ka ardhur si pasojë e keqkuptimit të faktit që janë shpenzime të vogla nën shumën 300,000 lekë, të financuara nga rroga çdo muaj.”

28.3 Komisioni konstaton se nga subjekti nuk janë deklaruar katër kredi konsumatore në vlerë totale 269,680 lekë, në periudhën 2010 – 2015, ku vlera e likuidimit në një vit deklarimi nuk i ka kaluar vlerën minimum të shpenzimeve, për të cilat subjekti kishte detyrimin t'i deklaronte.

28.4 Në vijim, nga analiza financiare për periudhën 2008 – 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera përgjatë viteve në të cilat janë shlyer këto kredi.

Për sa më sipër, pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të subjektit dhe shpjegimeve që ai ka dhënë, në përfundim të hetimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera përgjatë viteve 2011 dhe 2013 dhe periudhës 2014 – 2016.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij.
- iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarinimin më sipër nuk është në atë shkallë sa të përbëjnë shkak për shkarkim sipas pikës 3, të nenit 61, dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1 Pasuri | 0 | 411 510 | 100 000 | 0 | 600 000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Banesë private në bashkëpronësi me tre vëllezërit dhe prindërit në proces legalizimi 25%, pjesa takuese e subjektit 84.65 m ² | | | 100 000 | | | | | | |
| Automjet Land Rover Freelander blerë në vitin 2009 | | 411 510 | | | | | | | |
| Automjet tip Daimlerchrysler AG, blerë në vitin 2012, *** | | | | | 600 000 | | | | |
| 2 Detyrime | -92 464 | -108 049 | -103 375 | -131 172 | -239 838 | -222 119 | -38 576 | 56 793 | -56 793 |
| Kredi në Raiffeisen Bank subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, në shumën 1,000,000 lekë | -92 464 | -108 049 | -130 069 | -157 218 | -187 097 | -222 119 | -38 576 | | |
| Kredi në Raiffeisen Bank subjekti i rivlerësimit në vitin 2010 për blerje Trony | | | 26 695 | | -26 695 | | | | |
| Kredi konsumatore në Raiffeisen Bank bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2011 në shumën 77,900 lekë | | | | 23 850 | -23 850 | | | | |
| Kredi konsumatore në Raiffeisen Bank bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2011 | | | | 28 890 | -28 890 | | | | |
| Kredi konsumatore në Union Bank bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2015 | | | | | | | | 56 793 | -56 793 |
| 3 Pasuri neto | 92 464 | 519 559 | 203 375 | 131 172 | 839 838 | 222 119 | 38 576 | -56 793 | 56 793 |
| 4 Të ardhura | 1 087 884 | 1 546 634 | 1 268 176 | 1 763 456 | 1 318 624 | 1 324 046 | 1 565 710 | 1 554 200 | 1 651 356 |
| Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara | 754 214 | 848 131 | 897 044 | 847 556 | 846 998 | 852 420 | 1 040 569 | 1 025 312 | 1 199 766 |
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të dokumentuara | 333 670 | 250 299 | 290 792 | 438 870 | 471 626 | 471 626 | 525 141 | 528 888 | 208 581 |
| Të ardhura nga ISSH për leje lindje | | 48 204 | 80 340 | | | | | | 243 009 |
| Të ardhura nga shitja e autoveturës Volkswagen Passat me targa *** | | 400 000 | | | | | | | |
| Të ardhura nga dëshmipërbliimi si rezultat i aksidentit | | | | 477 030 | | | | | |
| 5 Shpenzime | 768 336 | 693 144 | 756 842 | 875 433 | 687 398 | 605 918 | 913 878 | 1 217 065 | 1 273 485 |
| Shpenzime jetese | 409 860 | 546 480 | 546 480 | 546 480 | 564 096 | 564 096 | 879 992 | 897 104 | 1 175 460 |
| Shpenzime mobilimi | | | 77 990 | 68 900 | | | | 93 990 | |
| Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë 1,000,000 lekë | 161 384 | 146 664 | 125 711 | 93 973 | 63 289 | 27 801 | 3 061 | | |
| Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë 77,900 lekë | | | 6 662 | 1 120 | | | | | |
| Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë 68,900 lekë | | | | 5 915 | 964 | | | | |
| Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë 28,890 lekë | | | | | 3 161 | | | | |
| Shpenzime interesi për shlyerjen e kredisë 93,990 lekë | | | | | | | | 5 731 | 3 336 |
| Shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS | 197 092 | 0 | 0 | 159 045 | 55 888 | 14 021 | 30 824 | 220 240 | 94 689 |
| 6 Likuiditete në fillim të vitit | -40 176 | -25 248 | 15 402 | 9 385 | 688 536 | 127 795 | 459 112 | 821 360 | 893 973 |
| Llogari rrjedhëse në Raiffesien Bank Subjekti | -60 085 | -34 177 | -17 259 | 9 473 | 2 437 | 9 007 | -22 657 | 2 000 | -7 879 |
| Llogari rrjedhëse në Raiffesien Bank bashkëshortja e Subjektit | 19 909 | 8 929 | 32 662 | -87 | 9 069 | -86 099 | -33 647 | -3 | 0 |
| Llogari në bankën ABI bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | -7 685 | -79 923 |
| Llogari rrjedhëse në Tirana Bank subjekti i rivlerësimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 477 030 | 22 | 0 | 0 | 0 |
| Llogari në bankën Union Bank bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 72 |
| Llogari kursimi në RFZ Bank vajza e subjektit të rivlerësimit | | | | | | 204 866 | 215 416 | 227 048 | 231 704 |
| Gjendje CASH sipas deklarimeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 200 000 | 0 | 300 000 | 600 000 | 750 000 |
| 7 Likuiditete në fund të vitit | -25 248 | 15 402 | 9 385 | 688 536 | 127 795 | 459 112 | 821 360 | 893 973 | 1 026 547 |
| Llogari rrjedhëse në Raiffesien Bank Subjekti | -34 177 | -17 259 | 9 473 | 2 437 | 9 007 | -22 657 | 2 000 | -7 879 | -3 256 |
| Llogari rrjedhëse në Raiffesien Bank bashkëshortja e Subjektit | 8 929 | 32 662 | -87 | 9 069 | -86 099 | -33 647 | -3 | 0 | 0 |
| Llogari në bankën ABI bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | | | | | | | -7 685 | -79 923 | 48 099 |
| Llogari rrjedhëse në Tirana Bank subjekti i rivlerësimit | | | | 477 030 | 22 | 0 | | | |
| Llogari në bankën Union Bank bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | | | | | | | | 72 | 0 |
| Llogari kursimi në RFZ Bank vajza e subjektit të rivlerësimit | | | | | 204 866 | 215 416 | 227 048 | 231 704 | 231 704 |
| Gjendje CASH sipas deklarimeve | | | | 200 000 | 0 | 300 000 | 600 000 | 750 000 | 750 000 |
| Diferenca (Të ardhura-Pasuri-Shpenzime+Likuiditete në fillim të vitit-Likuiditete në fund të vitit 4+6-3-5-7) | 212 155 | 293 281 | 313 976 | 77 700 | 352 129 | 164 693 | 251 008 | 321 315 | 188 504 |

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Vladimir Mara, ku ka konstatuar se:

- i. formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës;
- iii. për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- iv. në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Mara. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 20.11.2019. e KDZH-së

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykuesi vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Subjekti i rivlerësimit ka nisur punën si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 1.2.2000, duke e ushtruar këtë detyrë deri në datën 15.12.2003. Më pas, në janar të vitit 2004, deri në korrik 2008 ka vijuar punën si OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në Tiranë. Nga muaji gusht 2008, deri në muajin nëntor 2016, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga data 1 dhjetor 2016 e në vazhdim subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në Tiranë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, me vendimin nr. ***, datë 15.4.2019, ka miratuar aktin “Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Mara”, të datës 15.4.2019, të cilin e ka dërguar në Komision si pjesë të praktikës nr. *** prot., datë 19.4.2019. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale i kryer nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së është bazuar:

1. në formularin e vetëdeklarimit, si dhe në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
2. në pesë dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. në të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, e Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë dhe të Zyrës së Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga Komisioni u bazua në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe me kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka deklaruar të dhënat statistikore që lidhen me veprimtarinë në përgjegjësinë e tij, duke referuar si periudhë rivlerësimi periudhën 1.1.2014 – 31.12.2016.

(Shënim: pasaktësia apo mospërputhja e të dhënave ka lidhje me faktin se vetëm në tetor 2017 është vendosur në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit që të jepen të dhënat statistikore të subjekteve të rivlerësimit për tri vitet e fundit nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, që përkon me periudhën 8 tetor 2013 deri më 8 tetor 2016, ndërkohë që formulari i vetëdeklarimit është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për tri vitet e fundit kalendarike: vitet 2014, 2015 dhe 2016).

b) Përvoja profesionale në dhjetë vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, është emëruar prokuror me dekretin e Presidentit të Republikës të datës 29.7.2008 dhe nga kjo datë dhe deri më 8.10.2016 ka ushtruar funksionin e prokurorit:

- korrik 2008 – qershor 2016 ka ushtruar detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- qershor 2016 – në vazhdim ka ushtruar detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Në periudhën 2000 – 2008 subjekti i rivlerësimit ka punuar si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

c) Detyrat e kryera në tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Detyrat e subjektit të rivlerësimit, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë kanë konsistuar në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin dhe kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, përfaqësimin e çështjeve penale në gjykatë.

Lidhur me specializime në fushën e së drejtës nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar se ka përfunduar masterin profesional në të drejtë penale, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Për sa i përket të dhënave statistikore, prokurori Vladimir Mara ka deklaruar për vitet kalendarike 2014 – 2016 (*pra, 1 janar 2014 deri më 31 dhjetor të këtyre viteve*) dhe, siç përmendëm më lart, në rubrikën për sqarimin e saktësisë së të dhënave, ato nuk përputhen plotësisht me të dhënat e marra zyrtarisht në momentin e hedhjes së shortit, që bëjnë fjalë për periudhën objekt rivlerësimi (8 tetor 2013 deri më 8 tetor 2016).

Prokurori Vladimir Mara ka deklaruar këto të dhëna, lidhur me numrin e çështjeve të caktuar:

- **Numri i çështjeve të caktuara tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës:**

528 procedime penale dhe 211 materiale kallëzuese (mosfillime).

- **Numri i çështjeve të përfunduara tre vitet e fundit të detyrës:**

416 procedime penale dhe 211 materiale kallëzuese (mosfillime).

- **Numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës:**

21 procedime penale të mbartura në vitin 2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkollës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Sipas të dhënave të marra zyrtarisht në momentin e hedhjes së shortit mbi çështjet objekt rivlerësimi, rezulton se subjekti për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 ka trajtuar dhe përfunduar gjithsej 673 çështje.

ç) Trajnimet në tri vitet e fundit

Sa i përket trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda periudhës së rivlerësimit, prokurori Vladimir Mara, ka deklaruar pjesëmarrje në trajnimet si më poshtë:

- Tema “Ndryshimet në Kodin Penal, veprat penale në krimet kundër jetës dhe veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, data 5.4.2014.
- Tema “Rishikimi në procesin penal. Rastet dhe procedura e rishikimit”, datat 24 – 25 prill 2014.
- Tema “Problematikat që dalin në fazën e hetimeve paraprake. Problemet e evidentuara dhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese”, datat 29 – 30 prill 2015.
- Tema “Konfiskimi i aseteve kriminale të ligjit antimafia”, datat 2 – 3 nën

Lidhur me trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, prokurori Vladimir Mara ka deklaruar pjesëmarrje në trajnime, konkretisht si më poshtë:

- “Mbi krimin e organizuar, Trafikimin e mjeteve motorike dhe trafikimin e qenieve njerëzore”, organizuar nga OSBE-ja në Shkup, Maqedoni, në datat 20 – 21 tetor 2016.
- “Mbi krimin e organizuar”, në cilësinë e prezantuesit, në datat 12 – 13 dhjetor 2016.
- “Dorëzim i kontrolluar”, organizuar nga PAMECA IV, data 19.1.2017, ku subjekti ka qenë prezantues.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, ka deklaruar se ai ka dhënë mësim në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në lëndët “Kriminalistikë”, “Kriminologji” dhe “Procedurë penale”.

d) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit prokurori Vladimir Mara ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, konkretisht:

- “Kërkesë për ekzekutimin e letërporosisë”, datë 7.6.2016;
- “Konkluzione përfundimtare”, datë 4.12.2015, të çështjes penale nr. *** të vitit 2015;
- “Kërkesë për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit D. Z.”.

Tri aktet i përkasin viteve 2015 dhe 2016. Ekstremitetet e këtyre akteve gjejnë pasqyrim në rubrikën përkatëse të formularit, Rubrika C, pika 5. Në të tria rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë hartues i tyre.

Komisioni analizoi tri dokumentet e mësipërme në mënyrë të pavarur nga konkluzionet e arrira nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke arritur në përfundimin se:

- Nga përmbajtja e dokumenteve të mësipërme konstatohet se në to, nga subjekti i rivlerësimit janë respektuar përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale, tregohet i kujdesshëm në pasqyrimin e provave dhe në analizimin e tyre. Shpjegohen qartë hapat hetimorë të ndërmarrë deri në momentin e përpilimit të dokumentit, rezultati i hetimit dhe pasojat që mbart ky rezultat në plan ligjor.
- Nga pikëpamja formale, dokumentet e mësipërme paraqiten të mirëstrukturuara, me paragrafë, duke u vërejtur se subjekti bën trajtimin e çështjeve të veçanta nëpër paragrafët përkatës, duke ndihmuar që i gjithë teksti të paraqitet i kuptueshëm.

Pesë dosjet e shortuara:

- Me dosjen nr. 1 është përshkruar: “*Vendimi për mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2016*” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Me dosjen nr. 2 është përshkruar: “*Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***/2015*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Me dosjen nr. 3 është përshkruar: “*Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***/2013*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Me dosjen nr. 4 është përshkruar: “*Kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2014*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Me dosjen nr. 5 është përshkruar: “*Kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2014*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Të gjitha dosjet e përzgjedhura me short i përkasin periudhës së rivlerësimit. Komisioni mori në konsideratë analizën dhe vlerësimet e kryera nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, por i analizoi ato në mënyrë të pavarur, duke dalë në konkluzionin si më poshtë:

Dosja nr. 1, me përshkrimin: “*Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. */2016*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:**

Dokumenti ligjor “*Vendimi për mosfillimin e Procedimit Penal*”, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konstatohet se përbëhet nga tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-argumentuese dhe ajo konkluduese, të cilat përmbushin kriteret formale dhe përmbajtësore, të nevojshme për vlefshmërinë e tij.

Materiali kallëzues është regjistruar në datën 16.2.2016 dhe vendimi i mosfillimit është marrë në datën 15.3.2016.

Dosja nr. 2, me përshkrimin: “*Vendim për pushimin e procedimit penal nr. */2015*”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:**

Materiali referues mbi kallëzimin e shtetases F. P. është regjistruar në prokurori në datën 20.2.2015 dhe bazuar në urdhrin e zëvendës drejtorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës çështja i është kaluar për ndjekje prokurorit, subjektit të rivlerësimit Vladimir Mara.

Subjekti i rivlerësimit, me marrjen e materialeve, në datën 20.2.2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, pa emër të ndonjë personi të cilit i atribuohet vepra penale dhe në datën 25.2.2015 ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore për oficerin e policisë gjyqësore (urdhri – dërguar me shkresën nr. ***/ prot., datë 27.2.2015).

Dokumenti ligjor “*Vendimi për pushimin e Procedimit Penal*”, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konstatohet se përbëhet nga tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-argumentuese dhe ajo konkluduese, të cilat përmbushin kriteret formale dhe përmbajtësose, të nevojshme për vlefshmërinë e tij.

Në pjesën konkluduese, prokurori Vladimir Mara ka disponuar me pushimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, bazuar në germën “dh”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këtë dosje rezultuan këto gjetje:

- elemente kontradiktore në deklaratimet e dhëna nga kallëzuesja, e personit që ka dijeni mbi rrethanat e ngjarjes, si dhe e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, por nga subjekti i rivlerësimit nuk ka veprime të hetimit të thelluar mbi shkaqet e këtyre kontraditave;
- baza ligjore e vendosur nga prokurori në vendimin e pushimit, nuk përputhet plotësisht me pjesën arsyetuese;
- hetimi ka përfunduar pas kalimit të afatit ligjor.

Për gjetjet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, me kërkesë të Komisionit, dha shpjegime shtesë, të cilat u analizuan në tërësi, bazuar në pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, aftësia profesionale e subjektit të rivlerësimit (aspekti i njohurive ligjore dhe arsyetimi ligjor), çmohen pa gjykuar për korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

Nga sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se:

➤ **vendimmarrja e tij për pushimin e procedimit penal është rezultat i bindjes së tij të brendshme, të krijuar nga tërësia e akteve dhe e provave të ndodhura në dosje.**

Këto akte dhe prova janë rezultat i hetimit të kryer nga policia gjyqësore, e cila, nga ana e saj, ka qenë e urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit për kryerjen e veprimeve hetimore plotësuese, duke dalë në një përfundim që e relatojnë te prokurori i çështjes. Në fund, të gjitha materialet janë analizuar dhe vlerësuar brenda një logjike të subjektit të rivlerësimit, të cilën e gjejmë të shprehur në vendimin e pushimit të procedimit penal.

Në këndvështrimin e drejtuesit të prokurorisë, niveli i provave në dosje nuk krijonte bindjen për dyshim të arsyeshëm nëse shtetasi I. Plaka mund ta kishte kryer veprën penale. Për rrjedhojë, nuk krijonin as bindjen te subjekti i rivlerësimit për të shprehur mendim ndryshe ndaj urdhrin të drejtuesit të prokurorisë, shkak për të cilin procedimi penal ishte regjistruar pa emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

Në bazë të pikave 4 dhe 5, të nenit 24, të Kodit të Procedurës Penale (referuar përmbajtjes së ligjit në atë periudhë), përcaktohet se:

“4. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

5. Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.”

Në fashikullin e dosjes penale është administruar urdhri i datës 20.2.2015 i drejtuesit të Prokurorisë, në të cilin urdhërohet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të dhunës në familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, pa emër të personit të cilit i atribuohet vepra penale në fjalë.

Në këtë kuptim, rezulton se urdhri i regjistrimit të procedimit penal është atribut i drejtuesit të prokurorisë, i cili në urdhër përcakton dhe personat përgjegjës për zbatimin e tij, duke i lënë hapësirë për mendim ndryshe prokurorit të çështjes.

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka dërguar fashikullin e procedimit penal në Komisarriatin e Policisë Durrës për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore. Në zbatim të urdhrin të prokurorit, policia gjyqësore ka vijuar me hetimet, të cilat i ka përfunduar në datën 20.11.2015. Regjistrimi i procedimit penal pa emër dhe ridërgimi i dosjes penale për veprime hetimore më të thelluara kanë ndikuar në kohëzgjatjen e përfundimit të hetimit, të cilën subjekti i rivlerësimit e justifikon edhe me ngarkesën e punës së policisë gjyqësore.

Nga sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se:

➤ **kohëzgjatja e hetimit nuk është rezultat i mosveprimit nga ana e subjektit të rivlerësimit.**

Dosja nr. 3, me përshkrimin: “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. */2013”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:**

Vendimi nr. ***/2013 i pushimit të procedimit penal, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konstatohet se përbëhet nga tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-argumentuese dhe konkluduese, të cilat përmbushin kriteret formale dhe përmbajtëse, të nevojshme për vlefshmërinë e tij.

Në pjesën konkluduese, prokurori Vladimir Mara ka disponuar me pushimin e procedimit penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, bazuar në germën “dh”, të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këtë dosje rezultuan këto gjetje:

- elemente kontradiktore në deklaratimet e dhëna nga kallëzuesja, e personit që ka dijeni mbi rrethanat e ngjarjes, si dhe e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, por nga subjekti i rivlerësimit nuk ka veprime të hetimit të thelluar mbi shkaqet e këtyre kontradiktave;
- mbi gjetjet e mësipërme, me kërkesë të Komisionit subjekti i rivlerësimit dha shpjegime shtesë, të cilat u analizuan në tërësi, bazuar në pikën 4, nenin 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, aftësia profesionale e subjektit të rivlerësimit (aspekti i njohurive ligjore dhe arsyetimi ligjor), çmohen pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

Nga sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se:

➤ **vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes për pushimin e procedimit penal është rezultat i bindjes së tij të brendshme të krijuar nga tërësia e akteve dhe provave të ndodhura në dosje.**

Dosja nr. 4, me përshkrimin: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. 1973/2014”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:

Dokumenti ligjor “Kërkesa për gjykim” përmban përgjithësisht strukturën e përcaktuar nga neni 331, i Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me pjesën hyrëse, gjeneralitetet e të pandehurit dhe akuzën e ngritur ndaj tij, përshkrimin e faktit penal, listën e provave, si dhe në pjesën e analizës së provave, kërkimit të prokurorit për gjykimin e çështjes, datën e nënshkrimit e aktit, dhe komunikimit të të pandehurit e mbrojtësit të tij. Dokumenti është i vlefshëm në plan formal dhe përmbajtësor.

Kërkesa për gjykim e datës 11.12.2016 rezulton e strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa arsyetuese dhe pjesa konkluduese.

Në pjesën konkluduese, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, bën kërkimin për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit, duke vendosur edhe bazueshmërinë e kërkesës mbi dispozitën përkatëse procedurale.

Çështja e dërguar për gjykim është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në një seancë, si rezultat i pranimit nga gjykata të kërkesës për gjykim të shkurtuar (konkluzionet me shkrim nga prokurori dhe i pandehuri janë dhënë po në këtë seancë). Nga prokurori është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal, dhe dënimi i tij për këtë vepër, pas aplikimit edhe të nenit 406, të Kodit të Procedurës Penale, me 30 ditë burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar kërkesën e prokurorit duke e deklaruar fajtor të pandehurin sipas akuzës, vendim gjyqësor rezulton të ketë marrë formë të prerë në datën 2.2.2015, pa pasur ankim.

Dosja nr. 5, me përshkrimin: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. */2014”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:**

Dokumenti ligjor “Kërkesa për gjykim” përmban përgjithësisht strukturën e përcaktuar nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me pjesën hyrëse, gjeneralitetet e të pandehurve dhe akuzën e ngritur ndaj tyre, përshkrimin e faktit penal dhe listën e provave, si dhe në pjesën e analizës së provave, kërkimin e prokurorit për gjykimin e çështjes, datën e nënshkrimit e aktit, dhe komunikimit të të pandehurve e mbrojtësit të tij me shkresat përkatëse me nr. ***, datë 17.4.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kërkesa për gjykim i datës 14.4.2015 rezulton e strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa arsyetuese dhe pjesa konkluduese.

Në pjesën konkluduese, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, bën kërkimin për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurve, duke vendosur edhe bazueshmërinë e kërkesës mbi dispozitën përkatëse procedurale.

Nga aktet e fashikullit të procedimit penal me nr. ***/2014, të administruar nga Prokuroria e pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se: çështja e dërguar për gjykim është shqyrtuar nga Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me procedurën e gjykimit të shkurtuar. Në konkluzionet e datës 25.5.2015, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurve dhe dënimin e tyre. Gjykata, në vendimin e saj të datës 20.7.2015, ka vendosur sipas kërkesës së prokurorit për deklarimin fajtor të të dy pandehurve sipas akuzave përkatëse dhe llojit të dënimit, ndërsa në lidhje me masën e dënimit me burgim, për një të pandehur ka dhënë të njëjtën masë të kërkuar nga prokurori, ndërsa për të pandehurin tjetër ka dhënë një masë dënimi me burgim më të lartë nga ajo e kërkuar nga prokurori. Për këtë çështje është bërë rekurs dhe çështja nuk është shqyrtuar ende.

Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

Nga verifikimi i të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore nuk rezulton që subjekti Vladimir Mara:

- të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer;
- të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;

- të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);
- të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Lidhur me vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit

Për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësiwe profesionale dhe morale të prokurorëve”, pranë këtij sektori ka të dhëna si më poshtë:

- vlerësimi “*Shumë mirë*”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin **2014**;
- vlerësimi “*Shumë mirë*”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin **2015**;
- vlerësimi “*Shumë mirë*”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin **2016**.

Gjetjet nga Komisioni

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me urdhrin e datës 31.1.2018, ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2018, bazuar në kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme për vlefësimin e akteve në lidhje me procedurën e ekstradimit të shtetasit N. S., sipas informacionit të dhënë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë.

Sipas informacionit të dhënë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Prokuroria e Përgjithshme, në bazë të nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që të shprehet nëse mbi faktet e konstatuara në këtë rast ka apo jo shpërdorim detyre.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi analizoi aktet e vëna në dorëzim nga Prokuroria e Përgjithshme (ku gjendeshin materialet e vëna në dispozicion nga secila prokurori e shkallës së parë), pasi konstatoi se Ministria e Drejtësisë kishte kryer procedurat për ekstradimin e shtetasit N. S. dhe pasi konstatoi se ekstradimi, në kushtet hetimit të këtij shtetasi nën masën e arrestit me burg për llogari të procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është në kundërshtim me ndalimet e parashikuara në germën “c”, të nenit 491, të Kodit të Procedurës Penale, me urdhrin e datës 31.1.2018, urdhëroi regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga nenin 248 të Kodit Penal.

Me kërkesën e datës 8.5.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i ka kërkuar gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 31.1.2018, për veprën penale “shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga nenin 248, të Kodit Penal, bazuar në shkronjën “b”, të nenit 328/1 dhe 329/a të të Kodit të Procedurës Penale, sipas këtyre dispozitave ligjore:

Neni 328 (Pushimi i akuzës ose i çështjes)

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

[...]

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Neni 329/a (Kërkesa për pushimin e akuzës ose të çështjes)

1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.”

Në argumentimin e kërkesës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës vlerëson se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është përfshirë në procedurat e ekstradimit të shtetasit N. Se., por nga hetimi ka rezultuar se ka pasur një mosveprim nga ana e saj në lidhje me ekzekutimin e masave të sigurimit të caktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Prokuroria argumenton se, në parim, është Ministri i Drejtësisë subjekti të cilit ligji procedural i njej të drejtën për të vlerësuar pezullimin e ekzekutimit të ekstradimit, derisa gjykimi apo dënimi i personit ndaj të cilit është lejuar ekstradimi të ketë mbaruar apo të vendosë dorëzimin e përkohshëm të personit në fjalë, ose, nëse e vlerëson oportune, të kërkojë që dënimi i dhënë në Shqipëri të njihet apo të vijojë të ekzekutohet në shtetin kërkues, në bazë të nenit 500 të Kodit të Procedurës Penale.

Por kjo situatë ligjore e procedurale nuk e pengon mbrojtjen apo prokurorin që t’i drejtohet Ministrin të Drejtësisë dhe t’i kërkojë apo t’i vërë në dukje apo të sugjerojë pezullimin e dorëzimit apo dorëzimin e përkohshëm apo të tjerat sipas nenit 500 të Kodit të Procedurës Penale.

Në rastin konkret, në analizën e elementeve të veprës penale, prokuroria konstaton se mungojnë ana subjektive (dashje e drejtpërdrejtë) dhe pasoja e pariparueshme, si dy elemente të kërkuara nga neni 248 i Kodi Penal, që të mund të kemi veprën penale të shpërdorimit të detyrës, pasi hetimi ndaj shtetasit N. S., për llogari të procedimit penal nr. ***/2016, mund të vijojë pa pengesë, sipas mënyrave të tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, duke çmuar se faktet mund të përbëjnë shkak për procedim disiplinor.

Për sa më sipër, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se nga ana e subjektit ka pasur mosveprim në lidhje me ekzekutimin e masave të sigurimit të caktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Në çmuarjen e këtij rasti, në kuadër të rivlerësimit kalimtar, mbështetet në dispozitat ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 74 (aftësia organizative), të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:

“1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet [...] aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.”

Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit çmon se:

➤ **Nga subjektit ka pasur mosveprim në lidhje me ekzekutimin e masave të sigurimit të caktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, element ky i rëndësishëm në ushtrimin e detyrës si prokuror dhe, për këtë arsye, ta dërgojë këtë çështje pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me qëllim që ta shqyrtojë në bazë të nenit 100 e vijues**

të ligjit 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ANALIZA E GJETJEVE¹⁴

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Vladimir Mara, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme.

Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Vladimir Mara, për vitet 2014, 2015, 2016 të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit, ai është vlerësuar “Shumë mirë”.

a) Arsytimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, ka aftësi të mira në arsyetim ligjor. Aktet e përgatitura prej tij paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Subjekti i rivlerësimit, arsyeton qartë, duke referuar drejt në dispozitat ligjore përkatëse penale dhe procedurale.

Nga vlerësimet e bëra nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, është vlerësuar shumë mirë për aftësitë profesionale të shfaqura gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave të statistikave të cilat janë përdorur për short, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar 673 çështje, numër ky që tregon për një ngarkesë të konsiderueshme të lartë.

Konstatohet se subjekti Vladimir Mara ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit të çështjeve të caktuara në raport me ato të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

a) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga subjekti i rivlerësimit, veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje objektive. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

b) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e

¹⁴ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76, të ligjit 96/2016.

vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas shkresës nr. ***prot., datë 24.10.2018, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Vladimir Mara, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorit Vladimir Mara. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit prokurori Vladimir Mara të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi i subjektit është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurorit Vladimir Mara, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Vladimir Mara pas studimeve në drejtësi dhe pas një përvoje të gjatë pune si prokuror, ka përfunduar në vitin 2015 studimet "Master i nivelit të dytë në shkencat penale" në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Vladimir Mara, i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, sipas deklaramit të tij është angazhuar edhe në veprimtari akademike dhe të mësimdhënies në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në lëndët “Kriminalistikë”, “Kriminologji” dhe “Procedurë penale”, si dhe ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e prezantuesit në disa tema në fushën penale.

Vlerësimi i denoncimeve dhe vendimeve të paraqitura nga denoncuesit

Ndaj subjektit të rivlerësimit është depozituar një denoncim, konkretisht:

➤ **Denoncim nr. *** prot., datë 29.1.2019, në emër të shtetases M. N. N., e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për trajtim çnjerëzor dhe për paaftësi profesionale**

Denoncimi është regjistruar nëpërmjet *e-mail*-it dhe përmban deklaramin e gjeneraliteteve të denoncueses, faktet dhe rrethanat që i çmon se përbëjnë shkelje ligjore në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si dhe pasojat që i kanë ardhur. Denoncimi shoqërohet me një material shkresor “Memo, drejtuar prokurorit të çështjes V. Mara” dhe me vendimin nr. ***, datë 21.10.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për caktimin e masës së sigurimit.

Nga sa më sipër, denoncimi konsiderohet i plotë në përmbajtje dhe në formë, duke u respektuar kërkesat e nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

Denoncuesja pretendon se si rezultat i ndalimit të saj nga policia gjyqësore ka pësuar pasoja të rënda, pasi mungesa e saj në banesë, pranë fëmijës së mitur, në kushtet kur nuk u mundësua lënia e tij pranë asnjë të afërmi (në denoncim nuk referohet se ku ka qëndruar) i ka shkaktuar shqetësime të rënda.

Sipas dispozitave të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016: “Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe **prokurorët** vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

Dispozita i referohet neneve 71, 73 dhe 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”.

Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit çmon se:

➤ **denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, të subjektit të rivlerësimit.**

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Për sa më sipër, pasi u hetua, analizua dhe u vlerësua raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni arrin në konkluzionin se nuk ka indicie apo elemente nga të cilat të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 dhe në bazë të nenit 100 e vijues të ligjit 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni çmoi të dërgojë për vlerësimin etik dhe profesional pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dy çështje për inspektim dhe konstatim të shkeljeve të mundshme disiplinore për subjektin, konkretisht mosveprim në lidhje me ekzekutimin e masave të sigurimit të caktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për shtetasin N. S., si dhe faktin e përdorimit të një makine, e cila nuk ka qenë regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë duke respektuar të drejtat e personave nën hetim dhe të

viktimave, ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, në përfundim Komisioni e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara, “të aftë” në detyrën e prokurorit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Mara, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 dhe në bazë të nenit 100 e vijues të ligjit 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të dërgojë për vlerësimin etik dhe profesional pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dy çështje për inspektim dhe konstatim të shkeljeve të mundshme disiplinore për subjektin, konkretisht mosveprim në lidhje me ekzekutimin e masave të sigurimit të caktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për shtetasin N. S., si dhe faktin e përdorimit të një makine, e cila nuk ka qenë regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikat 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Mara, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë për vlerësimin etik dhe profesional pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dy çështje për inspektim dhe konstatim të shkeljeve të mundshme disiplinore.
3. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Pamela QIRKO
Kryesues

Firdes SHULI
Anëtar

Alma FASKAJ
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta